

Permbledhje Joteknike

ID 3.1 e. Perzjerja e cimentos ose perdorimi i cimentos ne mase te madhe, por jo ne sheshin e ndertimit, perfshire ambalazhimin dhe perzjerjen e cimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve te betonit dhe produkteve te tjera te cimentos

ID 7.3 c. Veprimtari qe nuk perfshihen ne pikat 7.3a ose 7.3b ose ne pikat e tjera te kesaj shtojce, qe perfshijne ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit ne lidhje me ndonje veprimtari prodhimi



Emri I Subjektit: “DESARET COMPANY”

Administratori: Sofije Shani

Nipt: K01816001J

Adresa qendrore: Rruga “Hysni Gerbolli”, pallati “Desaret”, prane Kryqit te kuq, kati perdhe, Njesia Bashkiake 11, Tirane.

Vendndodhja: Ish Ndermarrja e Ndertimit, Corovode, Skrapar

Tabela përmbledhese e permbjedhjes joteknike

1. Profili I operatorit	3
1.1 Proçesi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis	3
1.2 Kerkesat per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis te nje projekti	3
2. Përshkrimi i Instalimit;	5
2.1 Qellimi;	5
2.2 Subjekti investitor;	5
2.3 Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit;	5
2.4 Te dhena teknike te aktivitetit;	5
3. Identifikimi dhe vleresimi I shkarkimeve kryesore ne mjedis;	8
4. Identifikimi dhe vleresimi I ndikimeve ne mjedis te aktivitetit;	9
4.1 Analizimi I ndikimeve te pritshme ne mjedis;	10

1. Profili I operatorit

Subjekti “Desaret Company” do te pajiset me Leje Mjedisi tipi B, sipas legjislacionit aktual ne fuqi, per aktivitetin “Perzjerja e cimentos ose perdorimi i cimentos ne mase te madhe, por jo ne sheshin e ndertimit, perfshire ambalazhimin dhe perzjerjen e cimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve te betonit dhe produkteve te tjera te cimentos” dhe “Veprimtari qe nuk perfshihen ne pikat 7.3a ose 7.3b ose ne pikat e tjera te kesaj shtojce, qe perfshijne ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit ne lidhje me ndonje veprimtari prodhimi”, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me Nipt K01816001J dhe vendndodhje te ushtrimit te aktivitetit Rruga “Hysni Gerbolli”, pallati “Desaret”, prane Kryqit te kuq, kati perdhe, Njesia Bashkiake 11, Tirane. Subjekti eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me date 30.05.1996.

Qellimi i ketij projekti eshte ndertimi dhe funksionimi i impiantit te betonit dhe asfalto-betonit nga subjekti. Subjekti per zhvillimin e aktivitetit te tij do te disponoje brenda siperfaqes se lejuar nje betony nje asfalto beton, vend depozitimi te lendes se pare, zyre portative, tualet portative, grope dekantuese dhe nje shesh parkimi per mjetet e transportit.

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin ne funksion te tyre, detyron institucionet shtetore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave vleresimi te impaktit te tyre para ndertimit dhe venies ne funksion te aktivitetit.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne kerkesat e zhvillimit te aktivitetit nga subjekti “Desaret Company”

Ky raport perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit ne mjedis te aktivitetit te impiantit te prodhimit te betonit.

1.1 Procesi i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit te aktivitetit. Në procesin studimor të VNM përdoret informacioni dhe të dhënat teknike ekzistuese. Vleresimi i ndikimit ne mjedis hartohet qe ne fazen e projektidese per zhvillimin e aktivitetit, por gjithsesi edhe per aktivite ekzistuese te cilat jane objekt i nje leje mjedisore ose i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Sipas kushtetutes se Republikes se Shqiperise, shteti siguron me te gjitha mjetet dhe mundesite qe ka, nje mjedis te paster dhe te sigurte per qytetaret dhe brezat e ardhshem.

1.2 Kërkesat Vleresimin te Ndikimit në mjedis të një projekti

Vleresimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vleresimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

Vleresimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo

rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2.1 Qellimi i aktivitetit

Qellimi i funksionimit të këtij aktiviteti është prodhimi i betonit, asfalto betoni dhe funksionimi i tyre, duke marrë parasysh të gjithë dispozitat ligjore në fuqi, gjithashtu duke minimizuar në mënyrën më të mirë ndikimet në mjedis që mund të lindin nga zhvillimi i këtij aktiviteti. Gjithashtu edhe mirefunksionimi i të dy impianteve që do të posedojë subjekti Desaret Company

Në këtë raport vlerësimi do të vlerësojmë vetëm ndikimet e ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të prodhimit të betonit .

2.2 Subjekti investitor

Operatori “Desaret Company” do të ushtrojë aktivitetin në fushën e prodhimit të betonit dhe fraksionimit të interteve, në funksion të projekteve që do të ketë.

2.3 Vendodhja e aktivitetit

Adresa qendrore e aktivitetit është Rruga “Hysni Gerbolli”, pallati “Desaret”, pranë Kryqit të kuq, kati përde, Njesia Bashkiake 11, Tiranë, ndërsa adresa sekondare e ushtrimit të aktivitetit është Ish Ndermarrja e Ndërtimit, Corovodë, Skrapar me sipërfaqe të ushtrimit të aktivitetit rreth 2206 m².

2.4 Të dhëna teknike të aktivitetit

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit.

Materiali i thyer dhe i fraksionuar depozitohet në bunkerin e lende së pare, prej ku dozohet në mënyrë automatike së bashku me çimenton dhe transportohen për t’u perzjerë edhe me ujë dhe aditive të ndryshëm për prodhimin e betonit në përputhje me markat e betonit të kerkuara.

Procesi i dozimit dhe transportimit shoqërohet më së shumti me ujë me qëllim të evitimit të pluhurave në mjedisin rrethues. Përdorimi i ujit në dozim dhe transport eliminon pluhurat gjatë këtyre proceseve. Fabrika e betonit përbëhet nga dy sillos cimentoje, dy bunkere të ngarkimit me materiale inerte, një dhomë komandimi dhe një dhomë perzierjeje (mikseri). Fabrika punon në mënyrë automatike dhe mjafton që sillosat, bunkerat dhe dozoret të kenë sasine e nevojshme të lendes së pare për të krijuar receten e betonit sipas rekomandimeve të laboratorit. Materialet inerte që përdoren për prodhimin e betonit janë Cimento, rere, granil 1, granil 2, ujë. Ky impiant punon me energji elektrike e cila merret nga rrjeti. Harxhohet rreth 7500 kwh.

Lendet shtese që përdoren

Uji do të përdoret në prodhimin e betonit dhe do të merret në mënyrë private nga subjekti.


Inertet depozitohen në bunkere, pasi peshohen nëpërmjet një peshoreje sipas recepturës së projektuar në varesi të klases së betonit kalojnë në një transportier horizontal dhe më pas në një transportier diagonal, i cili e derdh materialin e perziere i cili ngarkohet në makinën betoniere.

Çimentoja nga sillosi i madh, me anen e nje shneku kalon ne nje sillos te vogel ku peshohet dhe me pas nepermjet nje shneku tjeter kalon ne makinën betoniere. Nga keto silose kemi gjenerim te pluhurave por ato jane hermetikisht te mbyllura dhe ky gjenerim eshte teper i ulet.

Uji hidhet ne makinën betoniere me anen e nje pompe, pasi matet ne aparatin dixhital sasia e projektuar per betonin.


Magazinimi i lendes se pare

Cimento sillet me bot cimentoje dhe depozitohet menjehere vetem ne sillosin perkates. Ne raste kur ka nevoja te medha per cimento ajo do te magazinohet ne rifuxho te mbuluar, te mbyllur dhe mbi paleta druri. Lendet e para si rera, granili 1 dhe granili 2 do te sillen nga operatore te licencuar me te cilet subjekti do te punoje ne baze te faturave ose kontratave.



Procesi i prodhimit te betonit

Linja e prodhimit te betonit eshte nje teknologji e parametrave bashkoheore ne te cilin cikli i prodhimit eshte teresisht i mbyllur dhe me kontakte teper minimale me elementet e mjedisit. Impianti i prodhimit te betonit ka nje strukture mbajtese te celikte te ndare ne 4 sektor te projektuara per mbajtjen e dozave se inerteve dhe me 4 valvula shkarkimi te inerteve. Cdo valvule eshte e ndare ne 4 bunkere per nje perzierje me te mire te inerteve.



Fabrika e asfalto-betonit ka si pjese kryesore perberese te saj elementet si me poshte:

1. Bunkerat e ngarkimit te materialeve inerte, zakonisht jane dy ose me shume dhoma ne te cilat depozitohen materiale inerte te diametrave te ndryshem, secila dhome e bunkerit eshte e pajisur me nje transportier me elektromotor;
2. Transportieri ngarkues qe con materialin ne sillosin e tharjes/ngrohjes dhe qe ben njekohesisht peshimin e materialit dhe con te dhena ne dhomen e komandimit;
3. Sillosi i tharje/ngrohjes dhe perzierjes se agregateve;
4. Depozita e karburantit (nafte, gaz ose energji elektrike) per sillosin e tharje/ngrohjes;
5. Selektuesin me sita dhe baze vibruese qe ben ndarjen e agregateve me madhesi me te madhe se ajo e lejuar per te hyre ne perpunim ne sillosin e perzierjes si dhe ben vecimin e agregateve neper sita sipas diametrave perkates;
6. Sillosi i perzierjes se agregateve me materialin mbushes dhe me bitumin e nxehur;
7. Sillosi i bitumit i cili eshte me ngrohje me sisteme gazi, sistemi qarkullimi vaji te nxehur ose direkt me energji elektrike dhe sillosi i materialit mbushes. Te dy sillosat jane te pajisur me nje transportier dhe kosha ngarkimi;
8. Filtrat e ajrit qe pengojne emetimin e pluhurave dhe gazrave ndotes ne ambientin perreth. Filtrat jane te llojit Te Thate (Dry dust collector) dhe Te Njome (Wet dust collector). Filtri i thate ben ndalimin dhe filtrimin e grimcave pluhurore me te medhaja ndersa Filtri i Njome ben ndalimin e grimcave pluhurore me diameter te vogel;
9. Transportieri ngarkues qe ben hedhjen e asfaltit ose direkt neper kamiona ose ne nje depozite tjeter nga ku me vone behet ngarkimi i kamionave;

10. Dhoma e komandimit nga e cila vendosen te gjitha komandat dhe sasite e nevojshme qe jane te percaktuara ne receten e asfaltit per krijimin e miksit te asfaltit;

Procesi teknologjik si punon fabrika e asfaltit

Fillimisht behet ngarkimi dhe mbushja e dhomave te bunkerit me agregate te diametrave te ndryshem ashtu sic eshte percaktuar ne receten e asfaltit. Secila dhoma e bunkerit eshte e pajisur me nje transportier me elektromotor qe ben percjelljen e sasise se nevojshme te atij diametri agregati ne sillosin e tharje/ngrohjes. Me ane te nje transportieri qe ben njekohesisht edhe peshimin e materialit agregatet cohen ne sillosin e ngrohje/tharjes. Per shkak se sillosi eshte i nxehur prej rezistencave qe ka ne brendesi, agregati qe sillet ne kete sillos thahet dhe e gjithe lageshtia e ketij materiali eliminohet. Brenda ketij sillosi ka nje mekanizem te brendshem qe ben here pas here perzierjen e agregateve ne menyre qe te sigurohemi se tharja eshte uniforme dhe homogjene.

Pasi eshte bere tharja e agregateve, me ane te zinxhirit transportues qe permban disa kosha me nje madhesi te caktuar behet kalimi i ketij materiali per tek sillosi i perzierjes se agregateve me materialin mbushes dhe bitumin e ngrohur.

Perpara se te kaloj ne sillosin e perzierjes se materialeve, agregatet futen fillimisht ne nje parastruktore qe quhet selektuesi me sita dhe baze vibruese qe ben ndarjen e agregateve me madhesi me te madhe se ajo e lejuar per te hyre ne perpunim ne sillosin e perzierjes, si dhe ben vecimin e agregateve sipas diametrave perkates.

Ky selektues me baze vibruese eshte plotesisht i mbuluar dhe i perbere nga disa shtresa. Sitat me diametra te ndryshme hapshire vrimash jane te vendosura vertikalisht mbi njera-tjetren. Sapo agregatet bien mbi keto sita vibruese fillon kalimi i tyre sipas diametrave perkates neper sitat me hapshire vrimash me te ulet. Agregatet me diameter te ndryshem nga ai i percaktuar nga receta e asfaltit largohen prej sitave vibruese.

Pasi procesi i selektimit dhe vibrimit ka mbaruar, te gjitha agregatet do te vecohen dhe depozitohen ne kompartimente te vecanta ne forme koshash. Keto kosha pervec vecimit te materialit bejne te mundur edhe peshimin e tij.

Si bitumi ashtu edhe materiali mbushes peshohen perpara se te hidhen ne sillosin e perzierjes se agregateve me bitumin dhe materialin mbushes. Nje kosh i hidroizoluar ben marrjen e sasise se nevojshme te bitumit nga sillosi i bitumit dhe e con ate ne sillosin e perzierjes. Te njejtin funksion kryen edhe koshi i cili ben marrjen dhe peshimin e materialit mbushes. Sillosi i bitumit eshte me ngrohje me sisteme gazi, ose direkt me ane rezistencash qe punojne me energji elektrike.

Pasi eshte bere ky selektim paraprak i agregateve, bitumit dhe materialit mbushes neper koshat perkates, ne menyre automatike behet shkarkimi i sasive perkatese sipas recetes se asfaltit ne sillosin e perzierjes. Ky sillos ka ne brendesi nje mikser i cili perzien materialet per nje interval te caktuar kohor. Ne menyre qe te ruhet sa me shume temperatura e perzierjes brenda sillosit, ky sillos eshte i termoizoluar me materiale speciale qe i rezistojne efekteve korroduese te proceseve kimike qe ndodhin brenda tij.

Ne menyre qe impakti i ketij procesi teknologjik te jete sa me minimal ne ambientin perreth, fabrika e asfaltit eshte e pajisur me dy lloje filtrash ajri. Filtrat e ajrit jane te llojit Te Thate (Dry dust collector) dhe Te Njome (Wet dust collector). Filtri i thate ben ndalimin dhe filtrimin e grimcave pluhurore me diametra me te medhaja ndersa Filtri i Njome ben ndalimin e grimcave pluhurore me diameter te vogel dhe gazrave te ndryshem qe emetohen gjate proceseve kimike qe ndodhin ne sillosin e perzierjes. Pajisja me keto lloje filtrash ndihmon ne emetimin e sa me pak gazrave te demshem ne ambientin perreth. Pasi eshte bere perzierja e duhur dhe eshte prodhuar asfalti sipas percaktimeve te recetes, mund te behet ngarkimi me ane te nje rripi transportues ose direkt neper kamiona, ose fillimisht ne nje depozite paraprake e mandej neper kamiona sipas nevojave te proceseve te punes.

E gjithë procedura e siperpermendur komandohet nga nje operator i kualifikuar qe pozicionohet ne dhomen e komandimit. Te gjitha proceset e punes jane te komandueshme nepermjet nje paneli kryesor i cili rregullon te gjitha proceset dhe kohezgjatjet perkatese qe ndodhin ne fabrike.

Procesi teknologjik ne fabriken e asfaltit krijon ujra minimalisht te ndotur vetem gjate fazes se pastrimit te tij. Duke qene se impianti eshte i perparuar teknologjikisht, jane shmangur te gjitha rrjedhjet apo perdorimet e panevojshme te ujit gjate funksionimit te tij. Sasia e ujit te gjeneruar qe duhet evakuuar eshte ajo gjate procesit te pastrimit te fabrikes. Kete sasi do e grumbullojme ne nje grope dekantimi dhe do perdorim ne kete rast disa shtresa filtrimi me ekrane rere per te ulur sa me shume sasine e lendeve qe mund te rezultojne te demshme per mjedisin.

Sasia e projektuar e impiantit te asfalto-betonit eshte **40 ton/ore** dhe siperfaqja qe ze impianti eshte 400 m².

3. Identifikimi dhe Vleresimit I shkarkimeve ne mjedis

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem. Nga zhvillimi I aktivitetit pritet qe te kete shkarkime minimale ne mjedis, duke iu referuar edhe natyres se tij. Disa nga shkarkimet e mundshme te ketij aktiviteti jane si me poshte vijon:

1. **Shkarkime ne ajer**- Ne kete grup shkarkimesh do te listojme shkarkimet e pluhurave qe mund te gjenerohen si pasoje e transportimit te lendes se pare ne vendodhje apo edhe ne sillosat perkatese te prodhimit te betonit. Edhe pse sistemi eshte totalisht hermetik, nuk e perjashtojme mundesine e shkarkimeve te pluhurave. Nje vater e mundshme e ketyre shkarkimeve mund te konsiderohet edhe sheshi I depozitimit te lendes se pare, sidomos ne kohe me ere, por operatori eshte kujdesur qe lenda e pare te fraksionohet dhe te depozitohet drejperdrejt ne sillosin perkates per te ulur probabilitetin e ngjarjes. Ne raste te vecante kur do kete kerkese me te larte te lendes se pare operatori do te mbuloje sheshin e depozitimit, sidomos ne kohe me ere. Per te minimizuar keto shkarkime operatori do te sprucoj me uje here pas here ne sasi te vogla, duke mos krijuar

keshtu edhe rrjesha ujore. Meqenese mjetet e transportit jane te tonazheve te renda mund te ndeshemi edhe me shkarkime te lehta te gazeve si pasoje e lendes djegese naftë qe perdorin mjetet e transportit. Per kete operatori do te kualidoje makinat komform legjislacionit actual, gjithashtu do ti kontrolloje ato ne menyre periodike ne serviset ku kryhen sherbimet e mirembajtjes.

Shkarkime do te kete edhe nga impianti I prodhimit te asfaltit si pasoje e lendes djegese dhe depozitimit te lendes se pare te cilat do te minimizohen me ate te dy filtrave qe impianti k ate instaluar (I thate dhe I njome)

2. **Shkarkime ne uje-** Kjo tipologji shkarkimi mund te na vije nga larja e makinave te betonit ose impiantit, por per minimizimin e ketyre shkarkimeve operatori do te ndertoje nje grope dekantuese ne ane te impiantit te prodhimit te betonit, ku do ti sygjerohet te jete me shtese materiali gjeotekstil e cila sherben edhe si nje forme filtri ne menyre qe toka te thithi vetem ujin e paster dhe llumi te qendroje ne sipërfaqe per tu terhequr me pas nga kompani te licencuara. Nese operatori do ta kete te pamundur nje ndertim te tille do ti sygjerohet pajisja me nje pompe te levizshme dhe pasi llumi te precipitoje uji te rifutet ne proceset e prodhimit, meqenese eshte uj I paster dhe nuk ndikon ne cilesine e procesit perfundimtar. Meqenese market e betoneve kerkojne sasi fikse uji perjashtohet mundesia e shkarkimeve te ujrave nga linja teknologjike. Edhe shkarkimet e mundeshme qe mund te na vijne nga procesi I prodhimit te asfaltit do te depozitohen po ne gropen dekantuese, pasi eshte me dy ndarje

3. **Shkarkimet ne toke-** Nga zhvillimi I ketij aktiviteti nuk do te kemi shkarkime ne toke. Mbetjet nga ky aktivitet do te evadohen ne menyren me te mire te mundshme. Mbetjet nga linja teknologjike do te perdoren per rehabilitimin e infrastruktures se brendshme. Meqenese ne kete infrastructure kalojne mjete te tonazhit te rende kerkon nje rehabilitim te here pas hershem.

4. Identifikimi dhe vleresimi i ndikimeve ne mjedis te aktivitetit

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm

Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake

Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore

Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit

Parimi i qasjes së integruar

Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit

Parimi “Ndotësi paguan”

Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut

Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e demtimi. Kjo perben perparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe

juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;

4.1 Ndikimet e pritshme ne mjedis nga zhvillimi I aktivitetit

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliohen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

Ndikime ne toke	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi i Impjantit te Prodhimit te Betonit	Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem.
Lëvizja e automjeteve të transportit dhe përdorimi i makinerive në procesin e ndërtimit	Si pasojë e lëvizjes së makinerive: <ul style="list-style-type: none"> - do të kemi ngjeshje të tokës në sektorë të veçantë të saj, - mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari me pasojë ndotje të tokës.
Magazininim i lëndëve të para dhe parkim i automjeteve	Si rezultat i përshtatjes së sipërfaqeve të caktuara për parkimin e mjeteve të punës dhe magazinimin e lëndëve të para, <ul style="list-style-type: none"> - mund të ndodhë ngjeshje e tokës.

Ndikime ne uje	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi i Impjantit te Prodhimit te Betonit Instalimi I Impiantit te Asfalto-Betonit	Shkarkimet ne ujera vijne nga: <ul style="list-style-type: none"> - Pastrimi i ambientit ne rast te shkarkimit te cimentos se lengshme, kryesisht nga nderprerja e punes per shkak te difekteve te mundshme ne impjant. - Ne rastet e pastrimit te automjeteve te transportit ne ambientin e kantierit, larja e autobetoniereve. - Ujerat e lagies se sheshit te qarkullimit te automjeteve. - d) Ujerat e perdorur per ambientet higjenosanitare te ambientit te stafit
Lëvizja e automjeteve të transportit dhe përdorimi i makinerive në procesin e prodhimit te betonit dhe asfalto betonit	Si pasojë e qarkullimit të mjeteve dhe përdorimit të mekanikës mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari e mundshme me pasojë ndotje të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
Magazininim i lëndëve të para dhe parkim i automjeteve	Rrjedhje vajrash dhe lubrifikantësh nga automjetet e parkuar Gjenerim pluhurash

Ndikime ne biodiversitet

OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi i Impjantit te Prodhimit te Betonit Instalimi I Impiantit te Asfalto-Betonit	Punimet per instalimin e impjantit te prodhimit te betonit do te shoqerohen me modifikim të pejsazhit ekzistues. Për të minimizuar këtë ndikim, operatori do te mbjelle fidane ne perimetrin rrethues te jashtem dhe te brendshem.

Ndikime ne ajer

OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi i Impjantit te Prodhimit te Betonit Instalimi I Impiantit te Asfalto Betonit	Si pasojë e lëvizjes së automjeteve do të gjenerohen: <ul style="list-style-type: none">- zhurma,- pluhur,- gaze nga djegia e karburantit të motorëve.